Abrogim – të shfuqizojë p.sh një ligj me një veprim formal apo autoritativ. Abrogimi i ligjit bëhet nga organet legjislative, si dhe nga organi që është kompetent për kontrollimin e kushtetutshmërisë së ligjeve (gjyqësori).
[Ang: **Abrogate;** Ser: **Abrogirati**]

Abstenim – Përmbajtja e qëllimshme nga detyra për të vepruar, posaçërisht përmbajtja nga votimi.
[Ang: **Abstention**; Ser: **Uzdržavanje**]

Acquis Communautaire – E gjithë e drejta e BE-së e akumuluar deri më tani.
[Ang:; **Acquis Communautaire** Ser: **Acquis Communautaire]**

Ad hoc (sin: impromptu) – [fjala latine "për këtë"] i formuar për qëllim të caktuar, p.sh një komision apo grup punues *ad hoc.*
[Ang: **Ad hoc;** Ser: **Ad hoc]**

Administrata – Zyrtarët dhe agjencitë e degës së ekzekutivit që zbatojnë politikat publike.
[Ang: **Administration;** Ser: **Administracija]**

Aklamacion – Akti i zgjedhjes së dikujt pa votim, zakonisht sepse kandidati nuk kundërshtohet ose nuk propozohet asnjë kandidat tjetër.
[Ang: **Acclamation;** Ser: **Aklamacija]**

Akt – Produkti formal i legjislativit apo organeve tjera shqyrtuese p.sh. statuti.
[Ang: **Act;** Ser: **Akt]**

Akt normativ – Çdo ligj, dekret, rezolutë, rregullore, urdhëresë administrative, udhëzim, rregull, urdhëresë apo akt tjetër i njohur dhe i përfaqësuar me forcë ligjore brenda një territori të caktuar nga autoritetet publike të atij territori; çdo marrëveshje ndërkombëtare të cilat konsiderohen si të detyrueshme nga e drejta ndërkombëtare.
[Ang: **Normative act;** Ser: **Normativni akt]**

Aktet nënligjore – Legjislacioni i nxjerrë nga autoritetet tjera nga qeveria dhe të cilat varen nga ndonjë autoritet më i lartë apo suprem sa i përket ligjshmërisë së tyre.
[Ang: **Sub-legal acts;** Ser: **Podzakonski akti]**

Amandamentimi (sin: ndryshim, plotësim) – rishikimi apo plotësimi formal i propozuar apo i bërë ndaj një ligji, kushtetutës apo akteve tjera legjislative.
[Ang: **Amendment;** Ser: **Amandman]**

Amnistia (sin: falje e përgjithshme, falje zyrtare, anulim i dënimit me vdekje) – Falja e bërë nga ana e qeverisë për një individ apo grup të personave, zakonisht për veprime politike apo vepra penale.
[Ang: **Amnesty;** Ser: **Amnestija]**

Aneks – shtojcë e aktit kushtetues apo legjislativ, ndonjë traktati ndërkombëtar apo pjesë përbërëse e ndonjë akti dhe ka autoritet të njëjtë ligjor sikur akti.
[Ang: **Annex;** Ser: **Dodatak]**

Anëtar sipas detyrës zyrtare – Marrë në përgjithësi është person i cili, në emër të zyrës apo pozitës që mbanë apo për shkak të përvojës, është në mënyrë jozyrtare pjesë e komisionit në cilësi që e ndanë atë nga personeli për hulumtim dhe këshilltari.
[Ang: **Ex-officio member;** Ser: **Član po položaju]**

Anulim – Akti i shfuqizimit apo bërjes së diçkaje të pavlefshëm.
[Ang: **Annulment;** Ser: **Poništenje]**
Aprovim – Pranimi apo konfirmimi i një akti apo vendimi nga një organ i caktuar.
[Ang: **Approval;** Ser: **Odobrenje]**

Asociacion Parlamentar (sin: grupet e miqësisë) – Shoqatë ndërkombëtare e cila mundëson forume për shkëmbim të ideve dhe informatave dhe për shkëmbim të njohurive dhe përvojave përmes kontakteve personale. Veprimtaritë kryesore të këtyre asociacioneve përfshijnë shkëmbimet, konferencat dhe seminaret lidhur me çështje të ndryshme.
[Ang: **Parliamentary association;** Ser: **Parlamentarno udruženje]**
Auditimi - Kontrollimi i dokumenteve të kontabilitetit apo përputhshmërisë me standardet e personit, organizatës, sistemit, projektit

apo produktit. Auditimet bëhen për të vërtetuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e informatave, si dhe për të siguruar një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm.
[Ang: **Audit;** Ser: **Revizija]**

Autoritet – E drejta ligjore e personit apo organit për të kontrolluar, vlerësuar, ndaluar apo drejtuar veprimet e të tjerëve, në bazë të ligjit, moralit, zakoneve apo pëlqimit; që zakonisht përdoren për të përshkruar një organ publik me funksion qeveritar apo funksion tjetër që rregullon veprimet dhe sjelljet e tjerëve.
[Ang: **Authority;** Ser: **Autoritet]**

Autorizim – Instrument i shkruar ligjor i lëshuar nga autoritetet publike për autorizimin e bartësit të tij për të kryer, në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara në të, të veprimtarisë apo projektit të caktuar.
[Ang: **Authorization;** Ser: **Ovlašćenje]**

Bashkimi Evropian – Organizatë supranacionale Evropiane e themeluar me traktatin për Themelimin e Komunitetit Evropian për Thëngjill dhe Çelik (ECSC), në Paris më 1951. Bashkimi Evropian më Vonë u zhvillua në Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Euro-Atom (Përmes Traktatit të Romës të vitit 1957). Sot njihet si Bashkimi Evropian (Përmes Traktatit të Maastricht-it të vitit 1991).
[Ang: **European Union;** Ser: **Evropska Unija]**

Betim – Premtimi solemn i bërë nën ndjenjën e përgjegjësisë se do të dëshmohet e vërteta gjatë deklarimit apo si vërtetim i deklaratës së dhënë.
[Ang: **Oath;** Ser: **Zakletva]**

Bojkotim – Refuzimi për të vepruar apo për tu marrë me ndonjë transaksion me qëllim të izolimit të një kundërshtari apo për të pranuar kushte më të dëshirueshme.
[Ang: **Boycott;** Ser: **Bojkot]**
Bruto Produkti Kombëtar (BPK) – Vlera monetare e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga një shtet gjatë një viti, përfshirë shkëmbimet tregtare me jashtë.

[Ang: **Gross National Product;** Ser: **Bruto nacionalni proizvod]**

Bruto Produkti Vendor (BPV) – Vlera monetare e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara brenda kufijve kombëtar gjatë një viti, duke përjashtuar shkëmbimet e tregtare me jashtë.
[Ang: **Gross Domestic Product (GDP);** Ser: **Bruto društveni proizvod]**

Burokraci – Çdo strukturë e madhe, e ndërlikuar administrative dhe e menaxhimit; organizatë hierarkike me punë të specializuara dhe rregulla të ndërlikuara.
[Ang: **Bureaucracy;** Ser: **Birokratija]**
Buxheti – Deklarata e një organizate apo të hyrat e përllogaritura dhe shpenzimet e qeverisë për një periudhë të caktuar.
[Ang: **Budget;** Ser: **Budžet]**
Çështje urgjente – Çështja që është e ndërlidhur me një urgjencë të vërtetë e cila nuk ka mundur të ngrihet në parlament ndryshe brenda kohës së arsyeshme dhe mbi të cilën kuvendi merr vendim.
[Ang: **Urgent matter;** Ser: **Hitna stvar]**

De facto – [nga latinishtja "bazuar në fakte"] që ekziston në fakt edhe nëse nuk njihet formalisht apo ligjërisht.
Krahaso me de jure.
[Ang**: De facto;** Ser**: De facto]**

De jure – [nga latinishtja "e bazuar në ligj"] Ekziston si e drejtë apo sipas ligjit.
Krahaso me de facto.
[Ang: **De jure;** Ser: **De jure]**

Decentralizim – Shprehja e përgjithshme për transferim të kompetencave dhe/apo përgjegjësive nga qeveria qendrore në institucionet lokale.
[Ang: **Decentralization;** Ser: **Decentralizacija]**

Dëgjim i komisionit - Takimi i thirrur nga komisioni për me qëllim të pranimit të dëshmive. Dëgjimet mund të mbahen për një çështje specifike që ka të bëjë me ndonjë propozim të caktuar legjislativ.
[Ang: **Committee hearing;** Ser: **Odborsko saslušavanje]**

Deklarata - Deklarim formal, proklamim apo njoftim.

[Ang: **Declaration;** Ser: **Deklaracija]**

Dekret – Akt nënligjor që nxirret nga qeveria dhe ka të bëjë më ushtrimin e funksioneve ekzekutive.
[Ang: **Decree;** Ser: **Dekret]**

Deputetë (sin anëtarë i parlamentit) – Përfaqësues i zgjedhur për parlament nga votuesit; person me të drejtë për t'u ulur në parlament.
[Ang**: Member of Parliament;** Ser**: Član parlamenta]**

Dëshmi – Diçka (që përfshinë dhënie të deklaratës dhe dokumenteve) që përdoret për të hedhë poshtë një fakt të supozuar.
[Ang**: Evidence;** Ser**: Dokazi]**

Dëshmim – Deklarimi si dëshmitarë i asaj që dini.
[Ang: **Testify;** Ser: **Svedočenje]**

Dëshmitar ekspert – Personi i cili thirret të paraqitët pranë komisionit për të paraqitur një mendim lidhur me një çështje të caktuar për të siguruar këshilla teknike lidhur me projektligjin.
[Ang: **Expert Witness;** Ser: **Svedok ekspert]**

Direktivë e BE-së – Akt individual i Bashkimit Evropian e cila nuk ka pasoja të mëdha ligjore për të gjitha shtetet apo për të gjitha çështjet, por vetëm për çështjen dhe shtetin të cilit i adresohet.
[Ang: **EU Directive;** Ser: **Direktiva EU]**

Disiplinimi partiak - Kontrolli i ushtruar nga partia ndaj pozitave që mbahen nga anëtarët e saj dhe ndaj mënyrës në të cilën anëtarët votojnë.
[Ang: **Party discipline;** Ser: **Partijska disciplina]**

Dispozitat e hyrjes në fuqi – Pjesa e projektligjit që jep pushtet autoriteteve të duhura për të sjellë në fuqi dispozitat e projektligjit.
[Ang: **Enabling clause;** Ser: **Klauzula koja daje ovlašćenje]**
Ditë pune – Dita e javës nga e Hëna deri në të Premten, duke përjashtuar pushimet zyrtare gjatë javës kur Kuvendi zakonisht takohet.
[Ang**: Working day;** Ser: **Radni dan]**

Dykuptimësi – Paqartësia e kuptimit apo qëllimit, p.sh të

një shprehjeje kontraktuese të një dispozite në ligj. Ekzistojnë dy lloje të dykuptimësisë ligjore: 1) dykuptimësia e fshehur: dykuptimësia që nuk duhet në formulimin e një dokumenti por që del në shesh kur kjo shprehje të aplikohet apo ekzekutohet. 2) dykuptimësia e dukshme e cila del nga gjuha e përdorur në një dokument.
[Ang: **Ambiguity;** Ser: **Dvosmislenost]**

E drejta Kushtetuese – organ i së drejtës që del nga kushtetuta dhe që trajton kryesisht pushtetet qeveritare, të drejtat dhe liritë civile.
[Ang: **Constitutional law;** Ser: **Ustavni zakon]**

E drejta ndërkombëtare – organi i rregullave dhe normave juridike që rregullon veprimtaritë që kryhen jashtë kufijve ligjor të shteteve.
[Ang: **International law;** Ser: **Međunarodno pravo]**

E parregullt – Në kundërshtim me rregullat e procedurës parlamentare. Kjo shprehje mund të aplikohet për mocionet, projektligjet apo çdo intervenim i cili shkon në kundërshtim me rregullat e organit legjislativ.
[Ang: **Out of order;** Ser: **Van reda]**

Ekzekutiv – dega e Pushtetit shtetëror që është përgjegjëse për të paraqitur dhe zbatuar ligjet; dega e pushtetit shtetëror që nuk përfshinë gjyqësorin dhe legjislativin.
[Ang: **Executive;** Ser: **Izvršna grana]**

Elektorati – Popullata që ka të drejtë të votojë për të zgjedhur kandidatët dhe partitë politike për t'i përfaqësuar ata në organin legjislativ.
[Ang: **Electorate;** Ser: **Izborno telo]**

Faza e komisionit – Studim i detajuar i neneve të projektligjit nga ana e komisionit. Kjo fazë, që mund të përfshijë dëgjimin e dëshmitarëve, është e para në të cilën mund të propozohen ndryshime lidhur me dispozita specifike në projektligj.
[Ang: **Committee stage;** Ser: **Etapa odbora]**

Fleta e renditjes – Dokument zyrtar i cili liston të gjitha punët që presin për tu bërë nga organi legjislativ.

Krahaso me agjendën.
[Ang: **Order paper;** Ser: **Dokument po redosledu]**

Futja e një dokumenti në agjendë – Vendosja e një dokumenti pranë organit legjislativ apo komisioni për shqyrtim
[Ang**: Table a document;** Ser**: Staviti na razmatranje]**

Gazeta Zyrtare (sin: Buletini) – Një gazetë zyrtare e cila publikon tekste të ligjeve të reja dhe vendimeve qeveritare.
[Ang: **Official gazette;** Ser: **Službeni list]**

Gjuhë joparlamentare – Fjalët që përdoren në parlament e që janë në kundërshtim me etikën parlamentare, që konsiderohen të ashpra dhe fyese.
[Ang: **Unparliamentary language;** Ser: **Neparlamentarni jezik]**

Gjykatë Kushtetuese – Organ i lartë shtetëror, i cili mbikëqyr dhe ushtron autoritet ndaj kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera ligjore.
[Ang: **Constitutional Court;** Ser: **Ustavni sud]**

Gjyqësori - Degë e pushtetit shtetëror përgjegjëse për interpretimin e legjislacionit dhe akteve tjera ligjore dhe për administrimin e drejtësisë; sistemi gjyqësor.
[Ang: **Judiciary;** Ser: **Pravosuđe]**

Grup i presionit (sin: grup i interesit, grup i avokimit) – Grup i njerëzve apo organizatave të bashkuara rreth një interesi të përbashkët dhe i themeluar për të bëjë fushata për ndikim në politikat zyrtare.
[Ang: **Pressure group;** Ser: **Grupe za pritisak]**

Grup Parlamentar – (sin: grup parlamentar, grup partiak) – Kuvendi i Kosovës: Një grup prej jo më pak se 5% përkatësisht 6 anëtarëve të Kuvendit të cilët e kanë njoftuar kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit lidhur me qëllimin për të vepruar si grup parlamentar.
[Ang**: Parliamentary Group;** Ser**: Parlamentarna grupa]**

Grupet e interesit (sin: grupet e avokimit, grupet e presionit) – Grupet e përbëra nga njerëz me mendime të njëjta të cilët bashkohen për një qëllim të

përbashkët dhe kërkojnë të ndikojnë në politikat publike.
[Ang: **Interest groups;** Ser: **Interesne grupe]**

Hyrja në fuqi (sin: nxjerrja, shpallja, miratimi) – dhënia e miratimit për sanksion legjislativ dhe ekzekutim të një projektligji i cili merr formën e ligjit.
[Ang: **Enactment;** Ser: **Donošenje pravnog akta]**

Hyrje – Procesi në të cilin një komb bëhet palë e një traktati që tashmë është në fuqi në mes të kombeve tjera.
[Ang: **Accession**; Ser: **Pristupanje**]

I nominuar – Personi i cili nominohet apo propozohet nga subjekti politik si kandidat për ndonjë post publik.
[Ang: **Nominee;** Ser: **Kandidat]**

I pari e merr postin (sin: fituesi i merr të gjitha) – lloji më i thjeshtë i sistemit elektoral, kandidati që pranon më së shumti vota fiton, apo i merr të gjitha, edhe nëse kandidati fiton më pak se 50 përqind të votave.
[Ang: **First-past-the-post;** Ser: **Princip najvećeg broja glasova]**

Impiçment – Akti (nga legjislativi) i thirrjes për shkarkim nga detyra e një zyrtari të zgjedhur, duke paraqitur akuzë me shkrim për sjelljen e supozuar të pahijshme të zyrtarit.
[Ang: **Impeachment;** Ser: **Obaranje]**

Implementim – Kryerja apo ekzekutimi; zbatimi i diçkaje apo veprimi.
[Ang: **Implementation;** Ser: **Primena]**

Imunitet – Status special i deputetëve në parlament i përcaktuar me dispozita kushtetuese, i cili mbron atë nga përgjegjësitë për fjalimet apo votimet gjatë punës së tij/saj dhe nga arrestimi dhe ndjekja arbitrare. Heqja e imunitetit kërkon votim nga parlamenti apo mjete tjera të përcaktuara me ligj.
[Ang: **Immunity;** Ser: **Imunitet]**

Inaugurim – Ceremonia në të cilën një zyrtar i zgjedhur apo

organ formalisht fillon punën në zyrë.
[Ang: **Inauguration;** Ser: **Inauguracija]**

Iniciative qytetare – (1) Grup i personave të cilët në mënyrë vullnetare bashkohen rreth një ideje, interesi, pikëpamje apo synimi të përbashkët. (2) Grup i qytetarëve të cilët me numrin e tyre plotësojnë pragun ligjor, të cilët mund të iniciojnë projektligje përmes peticionit.
[Ang: **Citizen's initiative;** Ser: **Građanska inicijativa]**

Institucion – Organizata apo grupi i organizatave të ndërlidhura që janë krijuar për një qëllim të caktuar.
[Ang: **Institution;** Ser: **Institucija]**

Interes vital – temë apo çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në një individ apo grup të individëve.
[Ang: **Vital interest;** Ser: **Vitalni interes]**

Interpelancë – E drejta formale e parlamentit për ti bërë pyetje formale qeverisë apo zyrtarëve qeveritar.
[Ang: **Interpellation;** Ser: **Interpelacija]**

Kabinet – Organ qeveritar, i përberë nga ministrat e qeverisë departamentet dhe kryeministri.
[Ang: **Cabinet;** Ser: **Kabinet]**

Kandidat i Pavarur – Individi i cili garon në zgjedhje pa qenë pjesë e listës së kandidatëve të një partie të certifikuar, koalicioni apo iniciative.
[Ang**: Independent candidate;** Ser**: Nezavisni kandidat]**

Kërkesa për votëbesim - Kërkesa e cila nëse miratohet, tregon që qeveria ka humbur besimin e organit legjislativ, gjë që rezulton me dorëheqje të qeverisë.
[Ang: **Motion of non-confidence;** Ser: **Predlog za neukazivanje poverenja]**
Kërkesë procedurale – Kërkesa që trajton mënyrën e kryerjes së një punë në organin legjislativ.
[Ang: **Procedural motion;** Ser: **Proceduralna inicijativa]**

Koalicion – Aleanca në mes të dy apo më shumë subjekteve politike apo të shoqërisë civile.
[Ang: **Coalition;** Ser: **Koalicija]**

Kodi – Përmbledhje e ligjeve, apo rregulloreve i organizuar sipas çështjes që trajton.
[Ang: **Code;** Ser: **Zakonik]**

Kodi i Mirësjelljes (sin: kodi i konfliktit të interesit) - Kodi që siguron standarde të përgjithshme për të bërë bashkërendimin e interesave private me detyrat dhe funksionet publike.
[Ang: **Code of conduct;** Ser: **Kod ponašanja]**

Koha për pyetje (sin: periudha për pyetje) – Koha e ndarë në rendin e ditës të sesionit plenar kur kryeministri dhe ministrat përgjigjen ne pyetjet e deputetëve të organit legjislativ. Krahaso me interpelancën.
[Ang: **Question time;** Ser: **Vreme za pitanja]**

Komision - Grup i njerëzve të emëruar apo zgjedhur për të shqyrtuar, përcaktuar apo menaxhuar një çështje. Ekzistojnë disa lloje të komisioneve legjislative: komisionet e përhershme, komisionet funksionale, komisionet kryesore, komisionet ad hoc. [Ang: **Committee;** Ser: **Odbor]**

Komisioni Evropian - Organi Ekzekutiv i Bashkimit Evropian i cili është i ngarkuar me implementimin e traktateve themeltare si dhe me qeverisjen dhe kontrollin. Komisioni Evropian është i përbërë prej komisionarëve (një nga secili shtet anëtar), dhe udhëhiqet nga Kryetari i Komisionit Evropian. Secili shtet anëtar emëron nga një përfaqësues për komision, por lista përfundimtare dhe kryetari zgjidhen nga Parlamenti Evropian.
[Ang: **European Commission;** Ser: **Evropska komisija]**

Konsensus – Një mendim apo vendim lidhur me një çështje e cila kryesisht pranohet nga të gjithë.
[Ang: **Consensus;** Ser: **Opšta saglasnost]**

Konflikt i interesit – Situata në të cilën ekziston konflikt në mes të interesave publike dhe atyre private të personit i cili mbanë pozitë zyrtare apo konfliktet në mes të pozitave të ndryshme që zyrtari i tillë mund t'i bartë.
[Ang: **Conflict of interest;** Ser: **Sukob interesa]**

Kriteret e hyrjes (sin: Kriteret e Kopenhagës) Rregullat që

definojnë nëse një shtet i plotëson kushtet për të hyrë në Bashkimin Evropian. Kriteret kërkojnë që shteti të ketë institucione që ruajnë qeverisjen demokratike dhe të drejtat e njeriut, një ekonomi funksionale të tregut, dhe që shteti të pranojë obligimet dhe synimet e BE-së (përfshirë edhe të drejtën e Bashkimit Evropian ose siç quhet ndryshe *acquis communautaire*).
[Ang: **Accession criteria;** Ser: **Kriterijumi za pristupanje]**

Kryeministër (sin: Premier, Kancelar) – Zyrtari më i lartë i qeverisë; i pari i qeverisë.
[Ang: **Prime Minister;** Ser: **Premijer]**

Kryesia (sin. Presidenca) – Subjekt i përbashkët administrativ dhe qeveritar i cili ekziston në një zyrë apo organ legjislativ.
[Ang: **Presidency;** Ser: **Predsedništvo]**

Kryesues (sin: kryetar, zyrtari udhëheqës) – Zyrtari udhëheqës i një komisioni apo takimi.
[Ang: **Chairperson;** Ser: **Predsedavajući]**

Kryesues i Komisionit - Personi i cili mbikëqyr punën e komisionit duke caktuar punët anëtarëve të komisionit, duke caktuar takimet e komisionit, rendet e ditës dhe duke udhëhequr komisionin.
[Ang: **Committee Chairperson;** Ser: **Predsedavajući odbora]**

Kryetari i Kuvendit (sin: folësi) – Zyrtari që kryeson kuvendin legjislativ i emëruar që t'i kryesojë të gjitha takimet e kuvendit në mënyrë të drejtë, të rregullt dhe të paanshme.
[Ang:**Assembly President;** Ser: **Predsednik Skupštine]**

Kuorum – Numri i kërkuar i anëtarëve të legjislativit apo organit deklarativ që mundëson nxjerrjen e vendimeve të plotfuqishme.
[Ang: **Quorum;** Ser: **Kvorum]**

Kushtetuta – Ligji themelor i një shteti, që themelon karakterin organizimin e qeverisë së tij, duke përshkruar masën dhe kufizimet e pushtetit të vet sovran dhe mënyrën e ushtrimit të tij.
[Ang: **Constitution;** Ser: **Ustav]**

Kuvendi (sin: parlamenti, legjislativi) – Organ i zgjedhur përfaqësues që ka pushtet legjislativ.
[Ang:**Assembly;** Ser: **Skupština]**

Legjislacioni – Procesi i bërjes dhe nxjerrjes së ligjeve; ligjet e nxjerra nga organi legjislativ.
[Ang: **Legislation;** Ser: **Zakonodavstvo]**
Legjislativi – shih Kuvendi.

Leximet – Fazat në të cilat kalon projektligji; që janë; leximi i parë, leximi i dytë dhe i treti. Projektligji paraqitet gjatë leximit të parë dhe debatohet gjatë leximit të dytë dhe të tretë.
[Ang: **Readings;** Ser: **Čitanja]**

Leximi i dytë – fazë në procesin legjislativ kur organi legjislativ shqyrton dhe vendos për ndryshimet e propozuara të një projektligji. Ligji mund të miratohet gjatë leximit të dytë.
[Ang: **Second reading;** Ser: **Drugo čitanje]**

Leximi i parë – Prezantimi i parë i projektligjit; faza në procedurat preliminare në të cilat merret leja për të shqyrtuar projektligjin.
[Ang: **First reading;** Ser: **Prvo čitanje]**

Leximi i tretë – Faza finale e përparimit të një projektligji përmes procesit legjislativ në të cilën projektligji dorëzohet për miratim përfundimtar.
[Ang: **Third reading;** Ser: **Treće čitanje]**

Ligji – Sistemi i rregullave dhe rregulloreve që sigurojnë bazë për shoqërinë për të funksionuar në mënyrë harmonike dhe të efektshme.
[Ang: **Law;** Ser: **Zakon]**

Lista të hapura – Lloj votimi në sistemet e përfaqësimit proporcional në të cilin zgjedhësit jo vetëm që shprehin preferencat e tyre për një apo më shumë kandidatë brenda listës së një subjekti. Në këtë mënyrë, votuesit mund të ndryshojnë renditjen fillestare të kandidatëve në listën e partisë.
[Ang: **Open list;** Ser: **Otvorena lista]**

Listë e mbyllur – Një lloj votimi në të cilin votuesit mund të votojnë vetëm për subjektin politik dhe listën e saj të kandidatëve. Votuesit nuk mund të shprehin preferencat e tyre

për asnjë kandidat në listën e subjektit.
[Ang: **Closed list;** Ser: **Zatvorena lista]**

Llogaridhënie – Njohja dhe marrja e përgjegjësisë për veprimet. Vendimet, dhe politikat përfshirë obligimin për të raportuar dhe sqaruar pasojat që dalin nga kjo.
[Ang: **Accountability;** Ser: **Odgovornost]**

Lobimi – Grupi i njerëzve dhe përfaqësuesve të interesave të caktuara të cilët bëjnë përpjekje për të ndikuar në politikat politike rreth një çështjeje të caktuar.
[Ang: **Lobby;** Ser: **Lobi]**

Mandati – Autorizimi për të ushtruar funksione të caktuara për një periudhë të caktuar kohore.
[Ang: **Mandate;** Ser: **Mandat]**

Ministër – Anëtar i qeverisë përgjegjës për një apo më shumë departamente qeveritare; ai ose ajo është njëherit edhe anëtar i kabinetit.
[Ang**: Minister;** Ser**: Ministar]**

Ministër i kabinetit – anëtarë i kabinetit; kryesues i departamentit qeveritar.
[Ang: **Cabinet Minister;** Ser: **Ministar kabineta]**

Ministri – Departament qeveritar i cili merret me veprimtari apo fushë të caktuar.
[Ang: **Ministry;** Ser: **Ministarstvo]**

Mocion – Kërkesë me shkrim apo gojore që kërkon nga kuvendi të shtron një çështje për shqyrtim apo debat.
[Ang: **Motion;** Ser: **Predlog]**

Mocion përmbajtësor – Propozim i vetëpërmbajtur i dorëzuar për miratim të Kuvendit dhe i hartuar në atë mënyrë që të jetë në gjendje të shprehë një vendim të Kuvendit (p.sh, të gjitha rezolutat janë mocione përmbajtësor).
[Ang: **Substantive motion;** Ser: **Sadržinski predlog]**

Moratorium – Një periudhë e pajtuar formalisht gjatë së cilës pezullohet një veprimtari specifike apo e planifikuar.
[Ang: **Moratorium;** Ser: **Moratorijum]**

Ndarja e pushteteve – Ndarja e pushtetit shtetëror në degë, secila me detyrat e veta specifike dhe të ndara.
[Ang: **Separation of powers;** Ser: **Podela vlasti]**

Ndërprerje e punimeve – Përfundimi i sesionit në parlament. Krahaso me shtyrje dhe shpërndarje.
[Ang: **Prorogation;** Ser: **Kraj sesije]**

Ndihmës i Komisionit - Personi i cili ndihmon komisionin në shqyrtim të legjislacionit, punëson ekspertë dhe kryen detyra tjera sipas nevojës.
[Ang: **Committee Assistant;** Ser: **Pomoćnik odbora]**

Neni (sin: klauzolë) – pjesa e ndarë dhe e dallueshme e një akti legjislativ.
[Ang: **Article;** Ser: **Član]**

Nën-komisioni – Nënndarja e komisionit e cila raporton dhe kryen punët në emër të komisionit.
[Ang: **Sub-committee;** Ser: **Pod-odbor]**

Nepotizmi - Preferencat e treguara nga dikush që është në pushtet ndaj të afërmve dhe shokëve, posaçërisht duke emëruar ata në pozita me pushtet ku ata mund të kenë përfitime dhe ndikim.
[Ang: **Nepotism;** Ser: **Nepotizam]**

Obstruksionist – Taktika penguese e përbërë nga fjalimet e shpeshta ose të gjata për të vonuar punën e organit legjislativ apo komisionit.
[Ang: **Filibuster;** Ser: **Opstrukcija]**

Organizatë joqeveritare OJQ – Organizata ndërkombëtare, kombëtare apo transnacionale me anëtarësi private. Shembujt tregojnë organizata fetare dhe humanitare; organizata joprofitabile që nuk janë të asocijuara me asnjë qeveri të cilat veprojnë me mirëdashje posaçërisht në fushën e të drejtave të njeriut, duke siguruar ndihmë emergjente apo ndihmë për të inkurajuar zhvillim të qëndrueshëm.
[Ang: **Non-governmental organization NGO;** Ser: **Nevladina organizacija NGO]**

Parlamenti – Shih Kuvendi

Parlamenti Evropian – Organi përfaqësues i Bashkimit Evropian, i përbërë nga anëtarët e zgjedhur përmes zgjedhjeve evropiane të cilat organizohen çdo pesë vite.
[Ang: **European Parliament;** Ser: **Evropski parlament]**

Parti opozitare – Partia politike që nuk është as në partinë që udhëheq qeverinë e as në koalicionin e partive që formojnë qeverinë.
[Ang: **Opposition party;** Ser: **Opoziciona parija]**
Parti Politike – Organizatë vullnetare politike e krijuar për ndikuar në procesin politik, e cila i bashkon njerëzit me synime të ngjashme politike dhe e cila konkurron në procesin zgjedhor.
[Ang: **Political party;** Ser: **Politička partija]**

Pengim - Ndërhyrja në administrimin e drejtë të ligjit, drejtësisë apo procesit legjislativ.
[Ang: **Obstruction;** Ser: **Opstrukcija]**

Përfaqësim Proporcional – Sistem elektoral ku një numër i ulëseve të fituara janë drejtpërsëdrejti të lidhura me numrin e votave të pranuara nga secila parti.
[Ang: **Proportional representation;** Ser: **Proportionalno prestavljanje]**

Periudha e Fushatës zgjedhore – Veprimtari politike, përfshirë takime, fjalime, demonstrime, parada etj dhe përdorim i mediave për të informuar elektoratin lidhur me platformën e një kandidati të caktuar apo partie politike me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve.
[Ang: **Electoral campaign period;** Ser: **Period izborne kampanje]**

Peticioni – Kërkesë formale e bërë nga Kuvendi përmes një dokumenti të shkruar me nënshkrime të votuesve.
[Ang: **Petition;** Ser: **Peticija]**

Pjesëmarrja civile - e apo që ka të bëjë me veprimet e qytetarëve të cilët punojnë me zyrtarët qeveritar drejt arritjes së një synimi të përbashkët.
[Ang: **Civic Participation;** Ser: **Građansko učešće]**

Plan Veprimi – Dokumenti i cili definon synimet dhe caqet dhe përshkruan një vizion të

përbashkët dhe parimet udhëzuese për të arritur synimin dhe caqet. Plani i veprimit mund të definojë edhe se kush do ta bëjë këtë, kur dhe si.
[Ang: **Action plan;** Ser: **Plan delovanja]**

Portofol – Detyrë e posaçme apo fushë specifike e përgjegjësisë së ministrit apo anëtarëve tjerë të qeverisë.
[Ang: **Portfolio;** Ser: **Portfolio]**

Pragu zgjedhor – Pragu i numrit minimal të votave të nevojshme për të pasur të drejtë në ulëse në sistemin elektoral të përfaqësimit proporcional.
[Ang: **Electoral quota;** Ser:**Izborna kvota]**

Preambula – Pjesë e ligjit që i paraprinë tekstit kryesor e cila thekson arsyet për paraqitjen e tij dhe përfundimin që synon ta arrijë.
[Ang: **Preamble;** Ser: **Preambula]**

Procedura Parlamentare - Një sërë rregullash që qeverisin procesin e vendimmarrjes që përdoret nga kuvendi gjatë shqyrtimeve.
[Ang: **Parliamentary procedure;** Ser: **Parlamentarna prodcedura]**

Procedurë – Metodë specifike e kryerjes së veprimeve legjislative apo gjyqësore.
[Ang**:** **Procedure;** Ser**:** **Procedura]**

Procesi i Hyrjes - Procesi përmes së cilit kombi bëhet palë në traktatin që tashmë është pranuar nga kombet tjera. Zakonisht përdoret si sinonim për aderim, ratifikim, pranim dhe miratim dhe ndodhë si në rastet kur traktati është i hapur për pjesëmarrje të shteteve të reja përmes ndonjë dispozite për hyrje ashtu edhe në rastin kur të gjitha shtetet tjera pajtohen për një gjë të tillë. Në rastin e parë hyrja nënkupton pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në shtetit të ri anëtarë në traktat, pa asnjë modifikim të marrëveshjes fillestare. Me hyrjen e mëvonshme, të një shteti të ri anëtar nënkuptohet, një marrëveshje e re në mes të të gjitha shteteve anëtare.
[Ang: **Accession process;** Ser: **Proces pristupanja]**

Procesverbal – Shënimet formale të shtypura të punës që është bërë gjatë një takimi të legjislativit, komisionit, të

përhershëm të posaçëm apo të përbashkët.
[Ang: **Minutes;** Ser: **Zapisnici sa sastanaka]**

Projektligj – Propozimi për ligj i dorëzuar në organin legjislativ, përmes zyrës së pranimit, për debatim dhe votim.
[Ang: **Draft law;** Ser: **Nacrt zakona]**

Protokolli – (1) Procedurë ceremoniale dhe etiketë e vështruar nga shefat e shtetit, diplomatët, organizatat e larta qeveritare dhe ndërqeveritare. (2) Traktati për ndryshimin e një traktati tjetër.
[Ang: **Protocol;** Ser: **Protokol]**

Publikim i votimeve – Procesi i bërjes publike të votave të regjistruara dhe sigurimit për publikun të rezultateve me numër renditës dhe individual dhe numrin e përgjithshëm të votave.
[Ang: **Published voting;** Ser: **Objavljeno glasanje]**

Pushteti Legjislativ – Autorizimi për të bërë, ndryshuar dhe miratuar ligje.
[Ang: **Legislative power;** Ser: **Zakonodavna vlast]**

Qeveri e koalicionit – Qeveri parlamentare në të cilën kabineti përbëhet prej anëtarëve të më shumë se një partie politike.
[Ang**: Coalition government; Ser: Koaliciona vlada]**

Qeveri e përkohshme – Qeveria që shërben gjatë periudhës së tranzicionit nga një qeveri e mëparshme në një qeveri të re.
[Ang: **Interim government;** Ser: **Prelazna vlada]**

Qeverisje elektronike – Përdorimi i teknologjisë informative (TI), e posaçërisht internetit si mjet për të mundësuar një qeverisje më transparente dhe efikase.
[Ang: **E-government;** Ser: **E-vlada]**

Raportim Financiar – Njoftim publik me detaje të caktuara financiare sipas ligjit nga kandidatët, partitë politike dhe subjektet tjera politike të përfshira në zgjedhje.
[Ang: **Financial disclosure;** Ser: **Finansijsko obelodanjivanje]**

Raportuesi – Anëtar i komisionit i cili emërohet nga

komisioni për të raportuar lidhur me projektligjin në takimet e organit legjislativ apo vetë komisionit.
[Ang: **Rapporteur;** Ser: **Izvestilac]**

Ratifikim – Konfirmimi formal nga shteti, zakonisht përmes veprimit legjislativ, i cili do të pranojë kushtet e traktatit apo konventës.
[Ang: **Ratification;** Ser: **Ratifikacija]**

Raundi i dytë i votimit - Raundi i dytë i votimit për një kandidat.
[Ang: **Runoff;** Ser: **Drugi krug glasanja]**

Referendumi – Procesi i referimit të një çështjeje politike apo ligjore te populata për miratim final nga vota e popullit.
[Ang: **Referendum;** Ser: **Referendum]**

Rekomandim i BE-së – Një udhëzim i përgjithshëm lidhur me zbatimin apo kryerjen e politikave të Bashkimit Evropian.
[Ang: **EU Recommendation;** Ser: **Preporuka EU]**

Rendi i Ditës – Një listë e pikave të punës që do të trajtohen gjatë një sesioni të Kuvendit apo komisioneve të tij.
Krahaso me orarin e punës.
[Ang: **Agenda;** Ser: **Dnevni red]**
Rezolutë – Mocion i shkruar që shprehë dëshirën e legjislativit apo organeve tjera deklarative përmes votimit.
[Ang: **Resolution;** Ser: **Rezolucija]**

Rregullore e BE-së - Akt i përgjithshëm juridik që vlen për të gjitha shtetet anëtare.
[Ang: **EU Regulation;** Ser: **Propis]**

Seancë me dyer të mbyllura – Dëgjimi që mbahet pa prezencën e publikut apo medias.
[Ang: **In camera hearing;** Ser: **Sednica iza zatvorenih vrata]**

Sekretari i komisionit (sin: koordinatori i komisionit, procesmbajtësi i komisionit) – Zyrtari procedural i cili vepron si zyrtar administrativ dhe këshilltar në procedurën parlamentare. Sekretari i komisionit mban procesverbalin e shqyrtimeve në të gjitha

takimet e komisionit dhe mund të hartojë edhe pyetje procedurale për kryesuesin e komisionit.
[Ang: Committee secretary; Ser: **Sekretar odbora]**

Sekretari i përgjithshëm – Zyrtari kryesor administrativ i një organi apo organizate.
[Ang: **Secretary General;** Ser: **Generalni sekretar]**

Sektori Publik – Institucionet e nivelit lokal dhe qendror, organizatat dhe agjencitë si dhe të gjitha bizneset, industritë dhe shërbimet në pronësi dhe nën kontroll të qeverisë.
[Ang: **Public sector;** Ser: **Javni sektor]**

Sesion Parlamentar – Periudha gjatë së cilës organi legjislativ mbanë takime të njëpasnjëshme.
[Ang: **Parliamentary Session;** Ser: **Parlamentarna sednica/zasedanje]**
Shërbim Civil (sin: shërbim civil) – Degë administrative të qeverisë; grup i njerëzve të punësuar në degët e qeverisë.
[Ang: **Civil service;** Ser: **Civilna služba]**

Shfuqizim – Anulim apo prishje, e një praktike.
[Ang: **Abolish;** Ser: **Aboliciaja**]

Shoqëri civile - përbëhet nga një numër i shoqatave dhe organizatave me anëtarësi të cilat bashkojnë njerëzit për të vepruar në fushën politike dhe atë të bërjes së politikave.
[Ang: **Civil society;** Ser: **Građansko društvo]**

Shpallje e ligjit – Akti i hyrjes në fuqi të një ligji apo rregullores.
[Ang: **Promulgation of law;** Ser: **Proglašenje zakona]**
Shpërndarje - Fundi apo përfundimi i punës së organit legjislativ para përfundimit të mandatit të tij.
Krahasoje me shtyrje apo ndërprerje e punimeve.
[Ang: **Dissolution;** Ser: **Raspuštanje]**

Shqyrtim gjyqësor – (1) E drejta kushtetuese e gjykatave ligjore për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimeve të legjislativit dhe ekzekutivit me kushtetutën; (2) pushteti i gjykatës për të shqyrtuar veprimet e degëve tjera të pushtetit shtetëror.

[Ang: **Judicial review;** Ser: **Pravosudno razmatranje (uvid)]**

Shqyrtimi-nen-për-nen - Faza e fundit e shqyrtimit të projektligjit nga ana e komisionit, ku përfshihet studim i detajuar i dispozitave të tij. Secili nen i projektligjit shqyrtohet veç e veç.
[Ang: **Article-by-article study;** Ser: **Proučavanje svakog člana pojedinačno]**

Shtyrje – Përfundim i sesionit për atë ditë, duke caktuar orën dhe ditën e takimit të ardhshëm.
Krahaso me shpërndarjen dhe ndërprerjen e punimeve.
[Ang: **Adjournment;** Ser: **Obustava]**

Shumica e kualifikuar – Vendim i marrë me votim me prag 50%.
Krahaso me shumicën absolute dhe shumicën e thjeshtë.
[Ang: **Qualified majority;** Ser: **Kvalifikovana većina]**

Shumica e thjeshtë – Shumica e të gjithë atyre që votojnë në një proces të caktuar zgjedhor.
Krahaso me shumicën absolute dhe shumicën e kualifikuar.
[Ang: **Simple majority;** Ser: **Prosta većina]**

Shumicë absolute – Shumica e të gjithë atyre që kanë të drejtë vote, pavarësisht se a kanë votuar apo jo. Shumica e votave nga përbërja e përgjithshme e organit legjislativ.
Krahaso me shumicën e thjeshtë dhe shumicën e kualifikuar.
[Ang: **Absolute majority**; Ser: **Apsolutna većina**]

Sistem parlamentar - Formë e qeverisjes e bazuar në supremacinë e organit legjislativ; sistem i qeverisjes në të cilin ekzekutivi sipas kushtetutës i jep llogari legjislativit.
[Ang: **Parliamentary system;** Ser: **Parlamentarni sistem]**

Sistemi Unikameral – Sistem parlamentar njëdhomësh.
[Ang: **Unicameral system;** Ser: **Jednodomni sistem]**

Sponsorues – Anëtari i cili e propozon projektligjin. Sponsorues mund të jetë edhe anëtari i Kuvendit apo qeveria.
[Ang: **Sponsor;** Ser: **Sponzor]**

Sundim i Ligjit – Epërsia e rregullave juridike dhe

kushtetuese ndaj njerëzve që jetojnë në një vend të caktuar.
[Ang: **Rule of law;** Ser: **Vladavina prava]**

Të drejtat kushtetuese – Të drejtat e garantuara me kushtetutë.
[Ang: **Constitutional rights;** Ser: **Ustavna prava]**

Thirrja në kuorum – Metoda e përdorur për të arritur prezencën e shumicës për transaksion të ligjshëm të punëve në takim.
[Ang: **Quorum call;** Ser: **Kvorumski poziv]**

Traktat – Marrëveshje formale me shkrim e bërë në mes të dy shteteve sovrane i nënshkruar nga përfaqësuesit e ligjshëm të secilit shtet, e që krijon apo kufizon të drejta dhe përgjegjësi të caktuara.
[Ang: Treaty; Ser: Sporazum]

Transkripta – Të dhëna të shkruara të shqyrtimeve gojore/debateve.
[Ang: Transcript; Ser: Transkript]

Transparenca – Zbulimi i plotë i saktë dhe me kohë i informatave.
[Ang: **Transparency;** Ser: **Transparentnost]**

Trupi zgjedhor (sin: zonë zgjedhore, elektorat) – organ i votuesve të cilët zgjedhin një përfaqësues për rajonin e tyre. Pjesëtari i trupit zgjedhor quhet zgjedhës.
[Ang: **Constituency;** Ser: **Birači izborne jedinice]**

Ulëset e rezervuara - Ulëset e rezervuara në parlament për individ ose grup specifik të individëve.
[Ang: **Reserved seats;** Ser: **Rezervisana mesta]**

Vendim i BE-së – Akt individual ligjor i Bashkimit Evropian i cili është i detyrueshëm vetëm për atë të cilit i adresohet.
[Ang: **EU Decision;** Ser: **Odluka EU]**

Veto – E drejta për të refuzuar lejimin e bërjes së diçkaje, posaçërisht të drejtës për të ndaluar një ligj që të kalojë apo marrjes së ndonjë vendimi.
[Ang: **Veto;** Ser: **Veto]**

Viti fiskal – Periudha dymbëdhjetëmujore që shfrytëzohet nga qeveria për

mbajtje të shënimeve, bërje të buxhetit, vendosje të tatimeve dhe aspekteve tjera të menaxhimit financiar.
[Ang: **Fiscal year;** Ser: **Fiskalna godina]**

Votëbesim – Testi për të vërtetuar nëse qeveria apo disa nga ministritë e saj ende kanë mbështetjen e shumicës absolute të deputetëve në organin legjislativ.
[Ang: Vote of confidence; Ser: Glasanje poverenja]

Votim Elektronik – Shfrytëzimi i pajisjeve elektronike dhe sistemeve të kompjuterizuara për të shënuar votat.
[Ang: **Electronic Voting;** Ser: **Elektronsko glasanje]**

Votim i njëzëshëm – Vota me marrëveshje të plotë të të gjithë atyre që kanë votuar.
[Ang: **Unanimous vote;** Ser: **Jednoglasno prihvatanje]**

Votimi - është metodë e zgjedhjes duke numëruar numrin e njerëzve në favor të secilës alternativë – zakonisht është hapi i fundit pas diskutimeve apo debateve. Krahaso me votim të hapur, votim të regjistruar dhe publikim të votimeve.
[Ang: **Voting;** Ser: **Glasanje]**

Votimi i hapur apo publik – Votimi përmes ngritjes së duarve apo forma tjera të të shprehurit publik.
[Ang: **Open or public voting;** Ser: **Otvoreno ili javno glasanje]**

Votimi i regjistruar – Votimi ku emrat e atyre që votojnë për dhe kundër një mocioni regjistrohen në regjistrat zyrtare të organit legjislativ apo të një nga komisioneve të tij. Votimi i regjistruar zakonisht merr njërën nga katër format në vijim: ndarja e anëtarëve, thirrja sipas rendit, votimi elektronik dhe votimi me letër.
[Ang: **Recorded vote;** Ser: **Zabeleženo glasanje]**

Votimi i vetëdijshëm - Votimi në organin legjislativ apo organet tjera shqyrtuese në të cilin deputetët janë të lirë të votojnë sipas gjykimeve apo besimeve të tyre dhe jodomosdoshmërishtë sipas udhëzimeve, politikave apo vendimeve të grupit të tyre parlamentar.
[Ang: **Conscience vote;** Ser: **Glas savesti]**

Zgjedhje të parakohshme – Zgjedhjet që mbahen si rezultat i shpërndarjes së parlamentit apo shkarkim të presidentit.
[Ang: **Early elections;** Ser: **Prevremeni izbori]**

Zgjedhjet - Veprimi me të cilin një organ apo institucion zgjidhet; procesi në të cilin njerëzit zgjedhin përfaqësuesit e tyre përmes votimit.
[Ang: **Elections;** Ser: **Izbori]**

Zyrtar i zgjedhur – Individ i cili i shërben publikut dhe i cili e ka marrë atë pozitë përmes zgjedhjeve.
[Ang: **Elected Official;** Ser: **Izabrani zvaničnik]**

PREDGOVOR

Priština, januar 2008.

Ovaj trojezični rečnik parlamentarnih izraza je najnovije izdanje koje je pripremila Centralna skupštinska jedinica OEBS-ove misije na Kosovu, koja svakodnevno radi na jačanju kapaciteta Skupštine Kosova.

Rečnik parlamentarnih izraza je još jedan važan doprinos za nastavak usmeravanja i usklađivanja procesa zakonodavstva na Kosovu. Rečnik je fokusiran na parlamentarne izraze koji se najčešće koriste u zakonodavnom procesu i skupštinskim postupcima, sa posebnom pažnjom na nove pojmove, nazive i koncepte koji su odomaćeni u parlamentu i EU. Rečnik teži da olakša rad pravnih službenika u Skupštini Kosova, ministarstvima i drugim zainteresovanim korisnicima ponudom definicija parlamentarnih pojmova na engleskom, albanskom i srpskom jeziku. Pošto su parlamentarne definicije kompleksne i stalno se menjaju, Rečnik se smatra promenljivim dokumentom koji je podložan dopunama i ažuriranju. Vaši predlozi i primedbe su dobrodošle na: glossary.omik@osce.org

I na kraju, Rečnik predstavlja čvrstu privrženost OEBS-ove misije na Kosovu kojom nastavlja da podržava reformu i funkcionisanje Skupštine Kosova kako bi nastavila da ispuni svoj mandat predstavljanja celog naroda Kosova.

Ambasador Tim Guldimann
Šef OEBS-ove misije na Kosovu

Abolicija – Poništiti ili ukinuti, posebno neku naviku.
[Eng: **Abolish**; Alb: **Shfuqizim**]

Abrogirati (sin: poništiti; opozvati) – ukinuti na primer jedan zakon zvaničnim ili merodavnim dejstvom. Abrogacija zakona se vrši od strane zakonodavnih tela, kao i od strane kompetentnog tela koji kontroliše ustavnost zakona (sudstvo).
[Eng: **Abrogate**; Alb: **Abrogim**]

Acquis Communautaire – Skup zakona EU koji su akumulirani do sada.
[Eng: **Acquis Communautaire**; Alb: **Acquis Communautaire**]

